



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 328/5 prot.

Tiranë, 29.8.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 14.8.2018, është njoftuar vendimi nr. 42, datë 18.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari, Prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, është Magjistrat/Prokurore prej vitit 2002 dhe aktualisht ushtron detyrën e Prokurores në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Duke qenë kandidate për anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë¹, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Antoneta Sevdari ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe vlerësimin profesional nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Antoneta Sevdari*”², ka referuar se:

- i. Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit³:

- i. Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

2.3 Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të formularit të vetëdeklarimit dhe 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka përcjellë pranë Komisionit⁴ raportin e hartuar për aftësitë profesionale të subjektit.

¹ Referuar nenit 279, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

² Protokolluar pranë KPK-së me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017.

³ Protokolluar pranë KPK-së me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017.

⁴ Protokolluar pranë KPK-së me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2018.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të subjektit, krahasuar me atë “Vetting”, kontrolli i gjendjes pasurore, burimin e krijimit, pagimi i detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për 2 pasuri të paluajtshme, 2 autovetura, të ardhurat, shpenzimet, likuiditetet dhe llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj (personi i lidhur) në shumën totale 29.606 euro dhe 32.357 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“...deklarimet e subjektit janë bindëse, të sakta dhe në përputhje me ligjin. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi* (f. 10-11 e vendimit).

4. **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës (f. 11 e vendimit).

5. **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe vlerësimit të 10 denoncimeve nga publiku, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 (f. 15 e vendimit).

6. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, Prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

7. Mbështetur në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, si një ndër tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka të drejtën e paraqitjes së ankimeve kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

8. Në identifikimin e shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik mban në konsideratë mbrojtjen e interesit publik dhe paraqitja e tyre juridiksionit rivlerësues pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bëhet me qëllim që procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektet e rivlerësimit të kryhet në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme mbi bazën e përcaktimeve kushtetuese e ligjore për secilin kriter kontrolli.

9. Komisioneri Publik vlerëson se vendimi nr. 42, datë 18.7.2018, shfaq mangësi në hetimin dhe kontrollin e dy kritereve, atij të pasurisë dhe atë profesional. Referuar kërkesave të nenit D dhe E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, në vështrim të provave të administruara, nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe nivel të mirë kualifikues të aftësive profesionale.

10. Komisioneri Publik çmon se mangësitë e konstatuara nuk i përgjigjen aplikimit të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe legjitimojnë kërkimin e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi ato mund të rregullohen nga ana e Kolegjit, referuar nenit F, pika 3 dhe 7, e aneksit të Kushtetutës.

11. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 e 66, të ligjit nr. 84/2016, në vijim paraqesim shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.

12. Paraprakisht, në mënyrë të përmbledhur, ankimi mbështetet në këto shkaqe:

12.1 Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion provues për ligjshmërinë e shumës 3.000.000 lekë (përfshirë shumën 12.000 euro, të siguruar nga puna e bashkëshortit në ***), deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burimi i krijimit të pasurisë për pjesën takuese 1/3 të truallit + ndërtesë, në ***. Detyrim ky nga neni D, pika 3⁵ e aneksit të Kushtetutës, neni 3/13 dhe 30 i ligjit nr. 84/2016.

12.2 Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion provues për ligjshmërinë e shumës 19.975,23 USD, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si e ardhur nga puna e bashkëshortit në ***. Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit dhe konfirmimit të transfertës, pa vlerësuar nëse kjo e ardhur plotëson kërkesat e nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

⁵ Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.* Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

12.3 Komisioni nuk ka hetuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramit për vitin 2010, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën 3.171.510 lekë. Kjo shumë ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament në ***.

12.4 Komisioni nuk ka hetuar lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 3.299.805 lekë, për vitin 2016.

12.5 Mangësi në hetimin e Komisionit vërejmë edhe në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale. Në lidhje me këtë kriter, Komisioni nuk ka hetuar dhe vlerësuar të gjitha denoncimet nga publiku, të cilat mund të përbëjnë indicie të mjaftueshme për një vlerësim të kundërt.

II.A Mangësitë e konstatuara, vlerësimi i Komisionerit Publik për kontrollin e kriterit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit

13. Vlerësimin e pasurisë, si një ndër tri shtyllat e procesit të rivlerësimit kalimtar, e gjejmë të rregulluar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, ku për justifikimin dhe ligjshmërinë e pasurisë në pronësi, posedim ose përdorim, subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur me të duhet të deklarojnë saktësisht dhe mjaftueshëmrisht të ardhurat, pra burimin e krijimit, e për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Nëse gjatë procedurës së hetimit administrativ të organit rivlerësues, në vlerësimin tërësor të çështjes, elementet e mësipërme nuk plotësohen, burimi i krijimit të pasurisë së subjektit nuk mund të konsiderohet si e ligjshme, rrjedhimisht për subjektin nuk mund të gjejë zbatim dispozita 59/1 e ligjit nr. 84/2016.

14. Në vështrim të këtij detyrimi kushtetues, Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se: *“...pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme...”*, duke zbatuar kështu parashikimet e nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, nuk i përgjigjet gjendjes së akteve të administruara për këtë qëllim. Komisioni nuk ka administruar dokumentacion provues mbi pagimin e detyrimeve tatimore për shumën totale prej 8,264,115 lekë, të ardhura këto të cilat kanë shërbyer si burim në krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

15. Shkaku (i). Nga vlerësimi i provave të administruara në fashikullin e Komisionit për pasurinë: truall + banesë 4 kate, në ***, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, na rezulton se Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion provues

për ligjshmërinë e shumës 3.000.000 lekë (përfshirë shumën 12.000 euro, të siguruar nga puna e bashkëshortit në ***), deklaruar si burimi i krijimit për pjesën takuese 1/3 e pasurisë.

15.1 Pasuria tokë-arë,⁶ me sip. 350 m², dhe shtëpi banimi 4 kate⁷, me kontribut për pjesën takuese në 1/3 të saj për vlerën 3.000.000 lekë është deklaruar në deklarin e interesave pasurorë në vitin 2004, deklarimi i parë i subjektit të rivlerësimit, e më pas në deklaratën “Vetting” 2017. Aktualisht truall⁸, sipas certifikatës së pronësisë të datës *.1.2016 dhe ndërtesa 4 kate mbi të, me sipërfaqe ndërtimore 125.9 m², referuar lejes së legalizimit nr.*** , e datës *.9.2013, dhe certifikatës së pronësisë e datës *.9.2013, rezulton në bashkëpronësi me pjesë takuese 1/3 në pronësi të bashkëshortit të subjektit z.***.***, z.***. *** (kunati i subjektit) dhe z.***.*** (nipi i bashkëshortit të subjektit).

15.2 Për burimin e krijimit, në deklaratën e interesave pasurorë të vitit 2004, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare: emigracion i bashkëshortit. Në deklaratën “Vetting” 2017 deklarohet kursime familjare të bashkëshortit dhe të ardhurat e tij si emigrant në **, gjatë viteve 1997-2000, ndërsa gjatë hetimit administrativ të Komisionit deklarohen edhe të ardhurat nga familja bujqësore e bashkëshortit dhe shumën 12.000 euro, nga puna e këtij të fundit, në vitin 2003, në **.

15.3 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar për këtë pasuri se: *“përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit. Për këtë pasuri, znj. Sevdari ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion, i cili e ka bindur trupin gjykues lidhur me krijimin e kësaj pasurie, herët në vitet 2000-2002, nga bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij. Znj. Sevdari fillimisht nuk ka qenë pjesëtare e kësaj familjeje, më tej ajo ka qenë studente e magjistraturës dhe nuk ushtronte funksionin e Prokurores. Ajo nuk ka kontribuar në blerjen e kësaj pasurie dhe as investuar për ndërtimin e saj”*.

15.4 Në vlerësim të Komisionerit Publik, referuar nenit D, pika 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, kontrolli i kriterit të pasurisë ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë në pronësi, posedim apo në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Për këtë arsye, subjektet e rivlerësimit në çdo rast duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive në raport me të ardhurat e tyre, të ardhura këto të cilat për t’u konsideruar të ligjshme duhet të jenë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore. Në aplikim të kësaj dispozite, si Kushtetuta ashtu dhe ligji nr. 84/2016, kontrollin e pasurisë ndaj subjekteve

⁶ Në DV 2003, vlera e blerjes deklarohet 1.4 milionë lekë, me pjesë takuese 50%, ndërsa në “Vetting” 700.000 lekë.

⁷ Fillimisht e deklaruar me sip.140 m², me pjesë takuese 25%.

⁸ Referuar urdhrin të regjistruarit të ZVRPP-së **, nr.**, datë *.6.2017, është korrigjuar lloji i pasurisë, nga “arë” në “truall”.

që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit nuk e kufizon apo kushtëzon me kohën e fillimit të detyrës së subjektit apo të përcaktojë periudhën e vlerësimit, si në rastin e kriterit të aftësive profesionale (neni 41/3 i ligjit), pasi për këtë kriter, detyrimi i subjektit është deklarimi i saktë dhe i mjaftueshëm i pasurisë që disponon ai dhe personi i lidhur në momentin e deklarimit për efekt të procesit të rivlerësimit, me qëllim kontrollin dhe justifikimin e burimit të krijimit të tyre.

15.5 Duke ju rikthyer rastit konkret, subjekti, znj. A. Sevdari, së bashku me bashkëshortin e saj (në cilësinë e personit të lidhur) kanë lidhur martesë ligjore në mars të vitit ***⁹ dhe subjekti i rivlerësimit është emëruar Prokurore në tetor të vitit 2002. Pasuria truall është blerë në korrik të vitit 2001 dhe banesa e tyre, në vlerën 3.000.000 lekë, dhe mobilimi, në vlerën 3.000 - 4.000 euro, i përket periudhës 2001 - 2003¹⁰. Në zbatim të nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, subjekti në deklaratën “*Vetting*” për burimin e krijimit ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit në emigracion për periudhën 1997 - 2000, fakt për të cilin ka dorëzuar edhe disa prova (blerje pulla siguracioni në shtetin ***), ndërkohë gjatë hetimit administrativ, pyetjeve të Komisionit, subjekti ka përfshirë edhe të ardhurat nga familja bujqësore e prindërve të bashkëshortit dhe të ardhurat e tij të vitit 2003, në shumën 12.000 euro, nga puna si inxhinier gjeodet në ***.

15.6 Konstatohet se për burimin e ligjshëm të pasurisë, Komisioni ka administruar vetëm tri dokumente të lëshuara nga Instituti *** i Sigurimeve Shoqërore, të cilat vërtetojnë blerje pullash sigurimi shoqëror për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 1998, por të cilat nuk provojnë nëse ato i referohen punësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit e, për më tepër, ato lidhen vetëm me një periudhë tremujore punësimi dhe jo trevjeçare. Komisioni nuk ka hetuar dhe analizuar asnjë fakt tjetër për periudhën 3-vjeçare të pretenduar të punësimit si emigrant në shtetin *** (1997 - 2000), si p.sh.: punën e kryer, shpenzimet e jetesës dhe pagimin e detyrimeve tatimore me qëllim arritjen e konkluzionit nëse të ardhurat e siguruar gjatë kësaj periudhe do të konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

15.7 E njëjta mangësi në hetimin e Komisionit, për burimin e ligjshëm, qëndron edhe për vlerën 12.000 euro, përfshirë si e ardhur nga puna e bashkëshortit si inxhinier gjeodet në *** , në vitin 2003. Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka paraqitur një deklaratë nga Shoqëria “ *** ” sh.p.k., e datës ***.1.2017, ku administratori i kësaj shoqërie deklaroi se bashkëshorti i

⁹ Referuar pyetësorit të KPK-së, së datës ***.2.2018.

¹⁰ Referuar deklaratimit të vetë subjektit gjatë hetimit administrativ.

subjektit, z.***.***, për periudhën qershor - dhjetor 2003, ka punuar në *** dhe është paguar nga kjo kompani në shumën 12.000 euro brenda vitit kalendarik 2003. Ndërsa në përgjigjen e dytë¹¹, kjo shoqëri pranon se nuk disponon asnjë kontratë punësimi për këtë fakt si shkak i kohës së gjatë që ka kaluar.

15.8 Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit dhe dokumentacioni i administruar nuk gjendet asnjë e dhënë mbi mënyrën se si është kryer pagesa dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore për t'i konsideruar ato si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Ky hetim ishte i nevojshëm nëse marrim në konsideratë edhe mosdeklarimin e kësaj të ardhure nga ana e subjektit në deklaratën vjetore të pasurisë.

15.9 Nga analiza dhe verifikimi i të ardhurave të ligjshme të bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit konstatojmë se për periudhën 2000 - 2003, në të cilën subjekti deklaroi se ka qarkulluar 3.000.000 lekë (për krijimin e 1/3 së pronësisë së tyre) dhe 3.000 - 4.000 euro për mobilim, të ardhurat e ligjshme nuk mbulojnë shpenzimin për pasurinë e vënë. Të ardhurat e ligjshme janë në shumën 1.869.447 lekë.

Tab.1 Të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit dhe subjektit, periudha 1997-2003, në lekë

Të ardhura nga pagat e subjektit ¹²	1,273,327 lekë
Të ardhura nga pagat e bashkëshortit pranë *** ¹³	596,120 lekë
Totali të ardhurave	1,869,447

16. Shkaku (ii). Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion provues për ligjshmërinë e shumës 19.975,23 USD, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si e ardhur nga puna e bashkëshortit në ***. Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit dhe konfirmimin e transfertës, pa vlerësuar nëse kjo e ardhur plotëson kërkesat e nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

16.1 Në deklaratën vjetore për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 18.970 USD, si të ardhura të krijuara nga puna e bashkëshortit si inxhinier pranë Shoqërisë “***”, në ***. Por, nga verifikimi i llogarisë bankare, shuma e përfituar nga këto transfertat është 19.975.23 USD. Subjekti në këtë rast ka kryer deklaram të pasaktë.

16.2 Për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, Komisioni ka vlerësuar se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e dhënë nga “***”, ku konfirmohet urdhëruesi i transfertës.

¹¹ Protokolluar pranë Komisionit me nr.***, datë ***.1.2018.

¹² Vërtetim i datës ***.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ***; vërtetim nr. ***, datë ***.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës.

¹³ Bazuar në listëpagesat e Shoqërisë “***” sh.p.k.

16.3*** konfirmon se në datat ***.4.2006 dhe ***.7.2006 janë kryer dy transferta, përkatësisht në shumat 9.982,97 USD dhe 9.987,26 USD, gjithsej 19.975,23 USD. Për këto transferta është konfirmuar edhe urdhëruesi, shtetasi italian, z. ***.***. Ky fakt ka qenë i mjaftueshëm për Komisionin për t'i konsideruar si të ardhura të ligjshme. Ndërsa ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2017, drejtuar Komisionit në lidhje me këto të ardhura shprehet se: *"...nuk janë përfshirë të ardhurat në shumën 20.000 USD në *** , pasi nuk shoqërohen më dokumentacion justifikues"*.

16.4 Në vlerësim të Komisionerit Publik, për të vërtetuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, nuk mjafton vetëm deklarimi i tyre dhe fakti se konfirmohet urdhëruesi i transfertës, pasi referuar kërkesave të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, subjekti duhet të provonte dhe Komisioni duhet të administronte dokumentacion që për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore. Në këto kushte, shuma prej 19.970,23 USD nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme.

17. Shkaku (iii). Komisioni nuk ka hetuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramit për vitin 2010, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën 3.171.510 lekë. Kjo shumë ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament në ***.

17.1 Apartamenti me sipërfaqe 101 m², në pronësi të z. ***.***, regjistruar me nr.***, z. k. nr.***, është blerë me anë të kontratës noteriale nr.*** prot. /*** kol., datë ***.9.2011, për çmimin 97.500 euro. Referuar vërtetimit hipotekor, prona është regjistruar më datë ***.9.2011 në regjistrin hipotekor me nr.***, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

17.2 Për burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar kursimet familjare nga pagat dhe të ardhurat e bashkëshortit si person fizik, inxhinier gjeodet dhe Komisioni ka arritur në konkluzionin se përputhen deklaramet e subjektit me rezultatet e hetimit.

17.3 Në vlerësim të provave të administruara, nuk pajtohem me këtë konkluzion të Komisionit, pasi është rrjedhë e një hetimi të mangët dhe mosvlerësimi të drejtë në lidhje me të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

17.4 Dokumentacioni i përcjellë për këtë qëllim nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore *** (DRT***) për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për vitin 2010, në shumën 3.171.510 lekë, është kontradiktor. Ky fakt pamundëson arritjen e një vlerësimi të drejtë në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për t'i konsideruar si të ardhura të ligjshme. Dokumentacioni mbi veprimtarinë ekonomike të realizuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën gusht - dhjetor 2010 konsiston në:

- Shkresën, kthim përgjigje nr. *** prot., datë ***.11.2016, e DRT***, ndaj kërkesës së z.***.***, tatimpagues me NIPT ***, ku shprehet se për vitin 2010 është realizuar fitim pas tatimit shuma 3.171.510 lekë.
- Shkresat nr.*** prot., datë ***.8.2017 dhe nr.*** prot., datë ***.8.2017 e DRT***, drejtuar ILDKPKI-së, për të njëjtin subjekt tatimpagues (NIPT ***), ku shprehet se **për vitin 2010 nuk ka të dhëna në sistem**, arsye kjo për të cilën ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2017, drejtuar Komisionit, shprehet se: *“nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga fitimi i aktivitetit si person fizik të z. ***.***, deklaruar në vitin 2010”*.
- Shkresa nr.*** prot., datë ***.4.2018, e DRT***, drejtuar Komisionit, në të cilën shprehet se: *“të dhënat janë nxjerrë nga pasqyrat financiare të dorëzuara në arshivë në datë ***.1.2016, me nr.*** prot. ...”*. Referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga vetë subjekti tatimpagues në vitin 2016 për vitin ushtrimor 2010, deklaroi fitim neto shumën 3.172.69914 lekë.
- Ndërkohë, nga nxjerrja e llogarisë bankare të personit fizik, z. ***.*** nga ***, rezultoi një pagesë e kryer në datë ***.3.2011, në shumën 335.148 lekë, me përshkrim *“tatim fitimi i biznesit të vogël”*.

17.5 Në vlerësim të këtyre provave, gjykojmë se analiza financiare e Komisionit për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë është kryer bazuar në përgjigje me përmbajtje të ndryshme dhe kontradiktore të administratës tatimore. Në këto kushte është e paqartë dhe jo bindëse, pse Komisioni ka marrë për bazë shkresën e DRT***, në të cilën kjo e fundit referon fitimin neto të vetëdeklaruar në pasqyrat financiare për vitin 2010, dorëzuar nga subjekti tatimpagues në vitin 2016, dhe jo shkresën e administruar nga ILDKPKI-ja, ku për të njëjtin subjekt tatimpagues nuk ka të dhëna në sistem.

17.6 Përballë këtyre paqartësive, Komisioni duhet të kishte hetuar më tej duke kërkuar nga DRT*** informacion më të plotë të situatës financiare të subjektit, si fitimin neto dhe pagimin e tatimit, të dhëna të cilat administrata tatimore duhet t'i disponojë për subjektin tatimpagues, pasi ky i fundit ka pasur detyrimin të deklarojë dhe të paraqesë çdo muaj dokumentet referuar kreut VI, seksioni 1, mbi “Detyrimin për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar, në bazë të të cilit subjekti kryen pagesën e tatimit mbi fitimin e realizuar. Hetimi i këtij dokumentacioni do të vërtetonte me saktësi xhiron, pagimin e detyrimeve

¹⁴ Në shkresën nr.*** prot., datë ***.11.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore ***, drejtuar subjektit, fitimi neto është 3.171.510 lekë, pra ka mospërputhje të shifrave të konfirmuara nga i njëjti institucion.

tatimore dhe fitimin e realizuar nga subjekti tatimpagues, duke kryer një analizë financiare të saktë mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë/apartamentit në vitin 2011.

17.7 Mbetet e paqartë gjithashtu edhe pagesa e kryer në datë ***.3.2011, në shumën 335.148 lekë, me përshkrim “*tatim fitimi i biznesit të vogël*”, pranë ***. Nisur nga fakti se sistemi nuk ka gjeneruar të dhëna mbi subjektin tatimpagues, vlerësojmë se Komisioni duhet t'i kërkonte bankës informacion mbi praktikën shoqëruese me të cilën është kryer kjo pagesë, pasi subjekti për të kryer pagesën e tatimfitimit në vitin 2011 (për vitin 2010) duhet të paraqiste një formular të deklarimit vjetor, konfirmuar nga autoritetet tatimore, bazuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor përkatës.

17.8 Sa më sipër konstatojmë se, për sa kohë nuk është saktësuar vërtetësia e këtyre të ardhurave dhe pagimi i detyrimeve tatimore, ato nuk plotësojnë kushtet e kërkuara nga neni D, i aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

18. Shkaku (iv). Komisioni nuk ka hetuar lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 3.299.805 lekë, për vitin 2016.

18.1 Për vitin 2016, subjekti tatimpagues (bashkëshorti) deklaron të ardhura nga biznesi, fitim neto, shumën 3.299.805 lekë. Nga aktet e administruara nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë Rajonale Tatimore *** (DRT***) konstatojmë se:

- Me shkresën nr. ***, datë ***.4.2018, drejtuar KPK-së, rezulton se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues për vitin 2016 është në shumën 3.299.805 lekë.
- Me shkresën nr. ***, datë ***.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se fitimi neto i realizuar nga ky subjekt tatimpagues për vitin 2016, për NIPT-in *** është në shumën 3.299.805 lekë, por subjekti ka detyrime tatimore të papaguara në vlerën 283,132 lekë dhe gjithashtu detyrime të mëparshme të prapambetura dhe të palikuiduara, që i përkasin NIPT-it ***, në shumën 80.000 lekë.
- Me shkresën nr. ***, datë ***.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues për vitin 2016 është në shumën 3.299.805 lekë dhe detyrimi i subjektit deri në datë ***.8.2017 për NIPT-in *** është gjithsej 337.104 lekë (80.000 lekë + 257.104 lekë) për të dyja NIPT-et.
- Me shkresën nr. ***, datë ***.1.2017, drejtuar ***, rezulton se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues për vitin 2016 është në shumën 3.299.805 lekë, duke u shprehur se subjekti nuk është objekt i pagesës së tatimfitimit.

18.2 Ashtu sikurse trajtuam për vitin 2010, edhe për vitin 2016 ndodhemi përpara faktit se përgjigjet nga ana e administratës tatimore kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe mbetet i paqartë

fakti nëse janë paguar detyrimet tatimore me qëllim legjitimimin e tyre në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Komisioni, duke qenë përballë faktit se administrata tatimore konfirmon mospagimin e detyrimeve fiskale nga subjekti tatimpagues, jo vetëm nuk heton më tej rreth këtij fakti, por i konsideron ato si të ligjshme.

II.B Mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale

19. Në zbatim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk kanë kualifikimin e duhur profesional për të ushtruar funksionin dhe të atyre të cilat kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Si burim për vlerësimin, për aq sa gjen zbatim, shërben edhe legjislacioni që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (nenet 68-78, të ligjit nr. 96/2016). Vlerësimi kryhet sipas kriterëve të aftësive profesionale të gjyqtarit/prokurorit, aftësive organizative, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, aftësive personale dhe angazhimit profesional. *Organet rivlerësuese ndihmëse* (Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme në këtë rast) *nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore në mënyrë të shkëputur nga veprimtaria e organeve të rivlerësimit, Komisioni dhe Kolegji, por nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre të fundit*¹⁵. Kjo nënkupton se institucionet e rivlerësimit nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura nga këto organe ndihmëse.

19.1 Në këtë kontekst, krahasimisht edhe me kompetencat kushtetuese e ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 49, 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që të drejtën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, të disponojë në marrjen e provave.

19.2 Në këto rrethana ligjore, Komisioneri Publik vlerëson se mangësitë e vërejtura nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale lidhur me denoncimet nga publiku për subjektin e rivlerësimit, përbëjnë shkak për rivlerësimin e këtij kriteri nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

19.3 Nga hetimi administrativ i Komisionit, në vlerësimin e 5 dosjeve penale të përzgjedhura, ka rezultuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit nr.***, datë ***.6.2016, të Gjykatës së Rrethit *** për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***.***”, vendim me të cilin subjekti është njohur dhe ka qenë prezent në seancën gjyqësore. Për këtë qëllim, Komisioni, me shkresën nr. *** prot. datë

¹⁵ Qëndrim i mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017.

.3.2018, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor *** dhe ka kërkuar kopje të dosjes penale, e cila në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale pasqyrohet si çështja nr..

19.4 Nga shqyrtimi i kësaj praktike rezulton se subjekti i rivlerësimit ka humbur të drejtën e ushtrimit të ankimit brenda afateve ligjore, megjithëse ka qenë prezent në dhënien e vendimit, dhe për këtë arsye ka paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit nr.***, datë ***.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ***, duke pretenduar *pritjen e zbardhjes së vendimit dhe, më pas, për arsye të rastit fator, pasi ka pasur familjarë të sëmurë, për të cilët është dashur të kujdesej.*

19.5 Referuar numërorit të vendimeve penale dhe civile të Gjykatës së Shkallës së Parë rezulton se dosja e vendimit të Gjykatës është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datë ***.6.2016, pra brenda afatit kohor, në mënyrë që çdo palë të kishte mundësinë të ushtronte të drejtën e ankimit¹⁶.

19.6 Gjatë seancës dëgjimore të datës 13.7.2018, para Komisionit, në lidhje me këtë rast, subjekti ka pranuar se: *“...Menjëherë sapo unë kam konstatuar, kam mbledhur dokumentacionin e nevojshëm dhe kam bërë kërkesë, ashtu siç u deklarua dhe në këtë seancë dëgjimore, për rivendosje në afat, kërkesë e cila u çmua nga Gjykata e Shkallës së Parë që nuk i përmbushte kushtet e rastit fator. Në këtë moment, unë jam njohur më thellësisht me praktikën gjyqësore dhe kam folur dhe me Prokurorë të Apelit dhe si konkluzion është arritur në përfundimin që rasti që unë paraqita para gjykatës, në fakt nuk përbënte rast fator. Kur u binda se, pavarësisht, se kisha shkak njerëzor që nuk bëra apelin, ai nuk përbënte shkak fator dhe për këtë arsye nuk vazhdova më tej, sepse mendova që nuk ishte më efektive”.*

19.7 Kjo përgjigje e subjektit të rivlerësimit, ku pranon se nuk njeh mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të *rastit fator*, ngre dyshime për aftësinë profesionale të subjektit, në kontrast kjo edhe me vlerësimin “e aftë” nga ana e Komisionit. Mbajmë në konsideratë se bëhet fjalë për candidate në një nga organet e sistemit të drejtësisë, siç është Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pas një eksperience 16-vjeçare në sistem.

19.8 Referuar nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se për aq sa është i zbatueshëm, procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për rastin në fjalë provohet se subjekti i rivlerësimit:

- Paraqet mungesë të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, referuar nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, pasi shfaq mungesë të aftësisë së Prokurorit për të interpretuar ligjin dhe mungesën e analizës dhe argumentimit logjik. Mungesa e aftësive profesionale, të pranuar nga vetë subjekti lidhur me përcaktimin e saktë të rastit fator, duke cilësuar si

¹⁶ Brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes ose e njoftimit të vendimit.

të tillë një rrethanë krejt të ndryshme nga sa përcaktohet nga teoria e së drejtës dhe praktika gjyqësore, ka sjellë si pasojë moskryerjen e detyrës nga ana e subjektit.

- Paraqet mungesë të aftësisë organizative, referuar nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të administruar dosjet gjyqësore. Kjo mungesë aftësie është reflektuar në tregues të tillë si mosrespektimi i afateve ligjore, të cilat kanë pasur efekt negativ në rezultatet e praktikës të trajtuar nga subjekti.

19.9 Vlerësimi i këtij rasti duhet trajtuar duke marrë në konsideratë edhe denoncimet nga ana e publikut për subjektin e rivlerësimit, denoncime këto të cilat ngrenë pretendime mbi aftësitë profesionale të subjektit. Neni Ç, pika 2, paragrafi i dytë dhe neni 53, i ligjit nr. 84/2016, lejojnë marrjen e informacioneve nga ana e publikut, të cilat kanë vlerë për procesin e rivlerësimit. Në këto kushte gjykojmë se Komisioni duhet të hetonte 10 denoncimet nga ana e publikut, ku disa prej tyre ngrenë pretendime të cilat kanë nevojë për trajtim dhe përgjigje. Komisioni, pa asnjë hetim dhe trajtim, nuk i ka marrë në konsideratë ato, megjithëse shqyrtimi tërësor i tyre mund të drejtonte në një vlerësim të kundërt për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

19.10 Si përfaqësues dhe mbrojtës të interesit të publikut në këtë proces, vlerësojmë se roli i publikut në ndihmë të institucioneve rivlerësuese me anë të denoncimeve të fakteve dhe rrethanave të besueshme dhe me vlerë për procesin e rivlerësimit, referuar nenit 179/b të Kushtetutës (rikthimi i besimit të publikut), nenit 43/4¹⁷ dhe neni 53, të ligjit nr. 84/2016, detyron Komisionin që në çdo rast, veç parashtrimin të rrethanave të çështjes së denoncuesit, të hetojë dhe arsyetojë në lidhje me pretendimet dhe faktet e denoncuar, dhe vlerën apo jo të tyre për procesin e rivlerësimit. Denoncimi në thelb përbën indicie për Komisionin e njëkohësisht detyrimin e këtij të fundit për të analizuar vlerën e tyre ligjore, nëse përbëjnë provë apo jo për procesin e rivlerësimit.

19.11 Përgjegjësia dhe përshtatshmëria e magjistratit dhe vlerësimi i tij, në radhë të parë, duhet kuptuar si *“pasojë e besimit të dhënë nga shoqëria/publiku mbi të”*, si një nga kushtet thelbësore, që, së bashku me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e tyre, përbëjnë sistemin efikas dhe efektiv të drejtësisë. Mbledhja dhe analizimi i informacionit nga publiku për përshtatshmërinë e subjektit, specifikisht faktet dhe rrethanat që mund të përbëjnë prova për veprimtari korruptive apo kontakte të papërshtatshme, pasuri, *sjellje joetike dhe profesionale, fakte mbi cilësi të papranueshme apo gjykim të dobët dhe mosrespektim i të drejtave të palëve*, është i rëndësishëm për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Vetëm

¹⁷ Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera... mbi fakte të besueshme... ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

nëpërmjet hetimit, vlerësimit dhe arsyetimit të vendimeve nga ana e Komisionit për këtë qëllim, publiku mund të udhëzohet dhe inkurajohet për paraqitjen e tyre, por nëse denoncimet nuk do të trajtohen apo trajtohen shkurtimisht, siç praktika e deritanishme ka treguar, bashkëpunimi i këtij aktori të rëndësishëm do të mungojë, fakt i cili pamundëson edhe realizimin e një ndër qëllimeve të procesit, rikthimin e besimit të sistemi i drejtësisë.

19.12 Roli i publikut “*në kontrollin e drejtësisë*” reflektohet në ligjin nr. 84/2016, ku në nenin 43, pika 4, përcakton se *në rast se relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49, të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale*, referuar kjo edhe nenit 53 të ligjit. Gjithashtu e gjejmë edhe në nenin 75 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016, ku përcakton se vlerësimi i aftësive të magistratit lidhur me etikën në punë, aftësitë personale dhe përgjegjshmërinë matet duke u bazuar në tregues të dalë dhe nga rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre.

19.13 Referuar arsyetimit të mësipërm, Komisioneri Publik konstaton se, megjithëse për subjektin janë depozituar 10 denoncime, hetimi i Komisionit për disa prej tyre ka munguar plotësisht. Për shembull, për denoncuesin, z. ***.***, i cili në ankesën e tij paraqet rrethana për një kallëzim penal, pretendon se subjekti i rivlerësimit, si Prokurorja përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural hetimi për 6 muaj. Denoncuesi ***.*** pretendon të njëjtin fakt, kur shprehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim dhe nuk e ka pyetur denoncuesin në lidhje me çështjen e kallëzuar prej tij. Shtetasi ***.*** pretendon se subjekti i rivlerësimit ka filluar procedimin penal mbi bazën e të dhënave nga një procedim penal të pushuar më parë. Ky denoncues pretendon se subjekti i rivlerësimit ka bërë kualifikim të gabuar të veprës penale në ngarkim të tij, ku ndryshe ishte regjistruar dhe ndryshe është vijuar procedimi penal. Gjithashtu pretendon se subjekti i rivlerësimit ka administruar prova në tejkallim të afatit hetimor, pra duke përdorur prova të cilat sipas K. Pr. Penale nuk mund të përdoren (neni 324/3 i K. Pr. Penale).

19.14 Referuar neneve 40 dhe 53/2¹⁸ të ligjit nr. 84/2016, pretendimet e mësipërme të denoncuesve, *prima facie* paraqesin rrethana të mjaftueshme, të cilat referojnë se subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në kriterin e aftësive profesionale, shkak i cili duhet të detyronte Komisionin të hetonte dhe vlerësonte më tej. Nga dokumentet e administruara, përcjellë nga Komisioni, konstatojmë se ky i fundit ka kërkuar dokumentacion për 4 raste të denoncuar e për të cilat sërish nuk reflektohet asnjë trajtim dhe vlerësim në vendimin e tij.

¹⁸ Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit...

19.15 Si përfundim, nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se hetimi i Komisionit ka qenë i mangët dhe në disa raste ka munguar plotësisht, megjithëse ka elemente që mund të drejtojnë në një vlerësim të kundërt lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin znj. Antoneta Sevdari.

III. Kërkimi i ankimit

20. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

21. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç, D dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë dhe atë profesional, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

22. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, pas hetimit të plotë të kriterit të kontrollit të pasurisë dhe atij profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Darjel SINA
Komisioner Publik